



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 340/ 2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur për shkak të dëmtimit të bilbordit të Agim Bahtirit nga subjekti politik AKR, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** si e palejuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR)

### A r s y e t i m

Me datën 10.06.2014, subjekti AKR, ka parashtruar një ankesë në PZAP, në të cilën ankesë deklarohet se duke u bazuar në faktet e dëshmitarëve dhe daljes në vendin e ngjarjes me datën 04.06.2014 rreth orës 15:10 sipas deklaruesit Samedin Jashari e i cili duke kaluar në rrugën Mitrovicë – Skenderaj afër varrezave të qytetit, ka hasur në një poster të djegur e cila i përkiste kryetarit të komunës dhe kryetarit të degës së AKR-së në Mitrovicë Agim Bahtiri.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejshmërisë së ankesës gjeti se:

### Ankesa është e palejuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi ankesën në fjalë gjeti se për këtë çështje PZAP-i ka vendosur më parë me vendimin e tij Anr. 161/2014 të datës 08.06.2014. Andaj meqenëse për të njëjtin vend dhe për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli vendosi që ankesën në fjalë ta hudhë si të palejuar.

PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 340/2014 më datën 11.06.2014.

Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala



### **Këshillë Juridike:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.